

## Mbledhja e Grupit të Ekspertëve të Standardizimit (GES)

(6 mujori i dytë, 2010)



Më datën 01 Korrik 2010, ora 10:00, në mjediset e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, u mbajt takimi i GES për 6 mujorin e dytë të vitit 2010 me rend dite sipas atij të njoftuar nga Z. Riza Hasanaj, drejtor i Drejtorisë së Standardeve dhe miratuar nga Z. Bashkim Muça, Drejtor i Përgjithshëm i DPS.

GES u mbledh për të shqyrtuar, konsultuar dhe marrë vendimin përfundimtar në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me organizimin, koordinimin dhe planifikimin e punës për standardizimin për 6 mujorin e dytë të 2010.:

- Programin 6- mujor të standardeve që do të miratohen si S SH;
- Propozimet për përbërjen e Komiteteve Teknike;
- Propozimet për kryesimin e këtyre Komiteteve.

### Rendi i ditës:

1. Hapja e mbledhjes nga Drejtori i Përgjithshëm i DPS, zoti Bashkim Muça.
2. Shqyrtimi i listave me standardet që propozohen të miratohen 6-mujorin e dytë të vitit 2010.
3. Shqyrtimi i komiteteve teknike të standardizimit (KT), që mendohen të kenë aktivitet gjatë 6-mujorit të dytë të këtij viti.
4. Ndryshime në përbërje të KT.
5. Të ndryshme.
6. Data e mbledhjes së ardhshme.
7. Konkluzione.

**Drejtor i Përgjithshëm i DPS** e deklaroi mbledhjen të hapur në praninë e shumicës së cilësuar të anëtarëve të GES. Për personat në mungesë theksoi se i kanë dërguar komentet e tyre me shkrim, në format elektronik. Në vijim, ai falenderoi pjesëmarrësit për praninë e tyre dhe për kontributin e vyer në fushën e standardizimit. Z. Muça theksoi se DPS e ka realizuar planin e saj për 6 mujorin që kaloi dhe është një ndër vendet e para në rajon për sa i përket adoptimit të standardeve Europiane.

Plani për fundin e vitit 2010 është arritja e vlerës 95% të standardeve evropiane të adoptuara si standarde shqiptare dhe avancimi i mëtejshëm në drejtim të plotësisimit së dosjes së 9 kushteve për anëtarësim me të drejta të plota në CEN dhe CENELEC (DPS planifikon të dorëzojë aplikimin e saj brenda vitit 2012).

Së fundmi Z. Muça informoi pjesëmarrësit se në muajin qershor është miratuar VKM për Bordin Drejtues dhe se DPS është në pritje të propozimeve nga institucionet përkatëse për anëtarët e tij. Si rrjedhojë e këtij zhvillimi në kuadrin ligjor, Grupi i ekspertëve (GES) do të mbledhet për herë të fundit nën këtë emër, sepse në vitin që vjen do të quhet Bordi Teknik.

Më pas fjalën e mori Z. Riza Hasanaj.

#### Z. Riza Hasanaj:

Së pari falenderoj të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre. Materialet e mbledhjes janë dërguar me postë elektronike dhe janë vënë në dispozicion në format *hard copy* në tavolinën e mbledhjes për anëtarët e pranishëm të GES.

Bazuar në pikën 2 të rendit të ditës le të shqyrtojmë standardet që propozohen të miratohen për programin e punës të 6-mujorit të dytë, për vitin 2010.



Diskutimet filluan me :

#### Z. Genti Guxho

Duhet vlerësuar nga DPS nevojat dhe mundësitë për shfuqizimin e standardeve puro shqiptare që konfliktojnë ose janë ekuivalente me standardet Europiane, dhe të shikohet mundësia për diskutimin e tyre në mbledhjen e GES, paralel me programin e punës për adoptimet.

#### Z. Anesti Ndreu

KT 298 “Pigmente dhe shpërndarës” ka patur në plan adoptimin e 9 standardeve Europiane të cilët nuk më rezultojnë të adoptuar.

#### Znj. Flutura Ahmeti

Në listën e standardeve të KT 104 janë disa Standarde që mund të adoptohen nga KT 138 “Prova pa shkatërrim” për arsye se i përkasin më shumë fushës që mbulon ky komitet.

#### Znj. Ilirjana Boçi

Lista e standardeve të KT 302 “Qumësht, mish dhe produktet e tyre” mund ti kalohet për adoptim KT 275 ”Analizat e ushqimeve” meqenëse këto standarde mund të konsiderohen



të kësaj fushe dhe KT 302 të lihet si komitet *dormant* me që nuk parashikohet të ketë punë në vijim.

Z. Agron Laçi

Propozoj që në KT 2 “Terminologjia dhe njësitë e matjes” dhe KT 8 “Pajisjet matëse. Teknikat e provës” të marrin pjesë anëtarë nga DPMK meqenëse këto komitete mbulojnë aktivitete me rëndësi për këtë drejtori.

**Grupi i Ekspertëve miratoi me ndryshimet e propozuara:**

- a) listën e standardeve për 6-mujorin e dytë të vitit 2010
- b) përbërjen e Komiteteve Teknike

-----  
*Për më shumë informacion Ju lutemi të na kontaktoni:*

*Tel: +355 (0) 4 222 62 55*

*Fax: +355 (0) 4 224 71 77*

*E-mail: [info@dps.gov.al](mailto:info@dps.gov.al)*

*Gjithashtu mund të vizitoni faqen tonë të internetit:*

*Web: [www.dps.gov.al](http://www.dps.gov.al) – Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit*

*Tiranë, më 02.07.2010*